KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Në kuadrin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë (KLSH) dhe Gjykatës së Llogarive të Turqisë (TCA) në 16 nëntor 2012, një grup prej 13 audituesish të KLSH, kryen një trajnim 5 ditor mbi "Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit (TI)". Trajnimi u zhvillua në datat 14-18 Prill 2014, pranë ambienteve të Gjykatës Turke të Llogarive (TCA), në Ankara.
Në fund të trajnimit audituesit të KLSH-së, u pajisën me çertifikatën e trajnimit, e cila u dorëzua personalisht nga Presidenti i Gjykatës Turke të Llogarive, Assoc. Prof. Dr. Recai Akyel.

Në trajnim u zhvilluan temat e mëposhtme:

1. Kuadri Ligjor dhe Organizimi i TCA-së
Në këtë temë u shpjeguar kuadri ligjor i TCA, si një Gjykatë Llogarish, dhe organizimi i saj. U shpjeguan dhe raportet e ndryshme që prodhonte TCA dhe mënyra e raportimit të tyre. Kjo temë u shpjegua nga audituesit e Grupit të Kërkimit dhe Zhvillimit të Auditimit, Trajnimeve dhe Publikimeve.

2. Menaxhimi i Teknologjisë së Informacionit (TI) dhe Projekteve të saj
Kjo temë u referua nga z. Necip Polat, Kryeauditues pranë TCA. Në këtë temë, z. Polat shpjegoi 3 çështje kryesore:

a. Kërkesat për një Projekt TI të Suksesshëm

Që një projekt TI të jetë i suksesshëm, ai duhet të plotësojë disa kushte themelore të cilat janë:

1. Duhet të jetë finalizuar procesi i tij
2. Duhet përcaktuar drejtuesi i procesit
3. Analiza e nevojave reale
4. Kërkesa e përbashkët (Jo individuale por institucionale)
5. Burimet (njerëzore dhe financiare)
6. Miratimi dhe mbështetja e Titullarit
7. Infrastruktura e TI
8. Përcaktimi i Ekipit që do ndjekë projektin
9. Mbështetja e Drejtuesve
10. Hartimi i Projektit (plani, programi)
11. Përdorimi i Burimeve
12. Mjedisi i punës
13. Menaxhimi i riskut

b. Projekti i Sistemit të Menaxhimit të Auditimit (SMA)

Në këtë temë, u trajtua procesi i përzgjedhjes së SAYCAP (programi që përdor TCA) dhe implementimit të tij. Ky program ishte në përputhje me strategjinë e TI të TCA, e botuar në 07.06.2007, e cila përfshinte:

Qëllimi strategjik 1.1. Rritja dhe forcimi i efektivitetit auditues me anë të përdorimit të TI.

Hapat që do hidhen:

1. Do krijohet infrastruktura në mënyrë që të dhënat e subjektit të audituar të merren në rrugë elektronike, për përdorim të mëtejshëm nga audituesit.
2. Të dhënat financiare të përditësuara do tu paraqiten audituesve në rrugë elektronike, nga ana e subjektit të audituar.
3. Do krijohet një SMA i tillë që procesi i planifikimit, zbatimit, analizës, raportimit, dokumentimit dhe kontrollit të cilësisë të kryhen në mjedisin elektronik. Ky sistem, në të njëjtën kohë të konsolidojë përfundimet e auditimit, gjithashtu dhe të mundësojë kryerjen në kohë të detyrave të caktuara.

c. Projekti i sistemit të menaxhimit elektronik të dokumenteve (SMED)

Ky ishte një projekt akoma i pafinalizuar, i integruar midis të gjithë institucioneve shtetërore, i cili u krijua në bazë të Ligjit Turk mbi Shkëmbimet Elektronike dhe Vendimit të Qeverisë Turke mbi detyrimin për përdorimin e sistemit elektronik të dokumenteve brenda një periudhe afatshkurtër (e papërcaktuar).

Ky projekt do përbëhej nga 4 elementë kryesorë:

- Sistemi i shkëmbimit (share) të dokumenteve: Sistemi me anë të të cilit kryhet shkëmbimi i informacionit me natyrë individuale ose institucionale.
- Sistemi i menaxhimit elektronik të dokumenteve: është sistemi i qarkullimit, krijimit të korrespondencës, numërimit dhe arkivimit të shkresave zyrtare.
- Menaxhimi i Sistemit të punës (proceseve): është sistemi i krijimit të formave elektronike, përpunimit të shkresave dhe përfundimit të tyre. Me qëllim automatizimin e të gjithë proceseve në institucion, sistemi duhet të zhvillohet vazhdimisht.
- Sistemi i Egzaminimit (Skanimit): është sistemi i cili egzaminon shkresat e ardhura dhe i drejton ato në proceset përkatëse.

3. Ndërgjegjësimi i TI

Kjo çështje ka të bëjë me të ashtuquajturin Revolucion Dixhital dhe historikun e tij ndër vite.

4. Risqet e bazave të TI

Risku në mjedisin e TI, është prania e një kërcënimi, i cili duke shfrytëzuar një dobësi të caktuar, mund të dëmtojë të dhënat e një organizate. Elementët kryesorë të këtij risku janë:

- Egzistenca e aseteve të informacionit që mund të dëmtohen
- Vulnerabiliteti
- Kërcënimi
- Mundësia për të ndodhur
- Impakti
- Kontrolli, kundërmasat

Formula e Riskut është:

$$\text{Risku} = \frac{\text{Asetet e Informacionit} * \text{Kërcënimi} * \text{Vulnerabiliteti} * \text{Mundësia} * \text{Impakti}}{\text{Kontrolli, Kundërmasat}}$$

Kemi 3 lloje risqesh:

- Risku Strukturor (i Trashëgueshëm)
- Risku i Kontrollit
- Risku i Zbulimit

Përballë Riskut, kemi 4 mundësi veprimi:

- **Pranimi i riskut** dhe mosbërja e asgjëje
- Marrja e masave për **zvogëlimin e riskut**
- **Transferimi i riskut** (sigurimi i tij)
- **Shmangja e riskut**

5. Kontrollet e TI

Kjo temë kishte si qëllim bërjen e lidhjes midis Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe Kontrolleve të TI (sipas Standardeve të ISACA). Në këtë temë, nga ana e lektorit u sollën disa shembuj realë të disa katastrofave të TI, të cilat kishin ndodhur si pasojë e mosmarrjes së masave të duhura nga sistemi i kontrollit të brendshëm.

6. Metodologjia e Auditimit të TI

Në këtë temë u prekën ndikimi që kishin TI, në auditimet e rregullshmërisë dhe/ose performancës, të cilat ishin:

- Mund të fshijë fare ose të bëjë të pakuptueshme **gjurmën e auditimit**,
- Ndryshon mënyrën e perceptimit të **dëshmisë së auditimit**,
- Krijon nevojën për **procedura të reja auditimi**,
- Krijon mekanizma të reja të **fajësisë dhe gabimeve**,
- Krijon mundësinë e ndryshimit të **paautorizuar ose pa lënë gjurmë**, të dhënave financiare ose me natyrë tjetër,
- Mund të krijojë mundësinë e hedhjes së të **dhënave dhe njëherë** (duplikim)
- Disa veprime duke qenë **të fshehta ose të padukshme**, zvogëlon mundësinë e **llogaridhënies**.

Qëllimi i auditimit të sistemeve të TI:

- Monitorimi i aktiviteteve që mundësojnë **plotësinë dhe besueshmërinë** e të dhënave të organizatës,
- Verifikimi nëse mbi ekzistencën dhe mjaftueshmërinë e kontrollove të brendshme, në sistemet e TI.

Lidhja e auditimit të TI me llojet e tjera të auditimeve:

- Auditimi Financiar; **siguria/plotësia/besueshmëria**,

- Auditimi i Pajtueshmërisë; **pajtueshmëria me legjislacionin**,
- Auditimi i Performancës; **Efektivitetit/Efiçenca**.

7. Teknikat e Auditimit me ndihmën e Kompjuterit

Në këtë temë u demonstruan aplikime praktike të përdorimit të teknikave kompjuterike gjatë auditimit. Aktualisht TCA përdorte, MS Access, MS Excel dhe ACL (e cila është e njëjtë me IDEA që përdorim ne, por për arsyen se nuk kishte përfaqësues zyrtar të IDEA në Turqi, u detyruan të përdornin ACL).

8. U demonstrua në praktikë programi i menaxhimit të auditimit që përdor TCA, SAYCAP.

U demonstruan dhe modulet dhe fazat e auditimit që përfshinte ky program.
Programi kishte 3 module:

1. **Moduli i Rregullimeve**; i cili konsistonte në rregullimet dhe hedhjen e përdoruesve, modul në të cilin kishin akses vetëm 2 administratorë të rrjetit (auditues të TI),
2. **Moduli i Menaxhimit të Auditimit**; i cili përfshin fazat e mëposhtme:
    a. Planifikimin e Përgjithshëm (Vjetor) të Auditimeve,
    b. Planifikimin e Auditimit,
    c. Zbatimin e Auditimit,
    d. Raportimin (Projekt-Raportin dhe Raportin Përfundimtar)
3. **Moduli i Monitorimit**, i cili mundësonte ndjekjen e punës audituese nga instancat superiore (psh, Përgjegjësi i grupit monitoron punën e anëtarëve të grupit, Drejtori i Departamentit monitoron vetëm punën e anëtarëve të departamentit të tij, Kryesia monitoron punën e të gjithë departamenteve audituese).

Ky ishte një program shumë i nevojshëm për TCA dhe u rekomandua përdorimi i tij. Ishte programi i cili përfshinte më shumë faza të auditimit, se çdo program tjetër i përdorur nga cilido SAI në botë. Ky Program i cili kategorizon nivelin e aksesit të secilit përdorues dhe nuk të lejon mundësinë e ndryshimit dhe/ose fshirjes së të dhënave apo punimeve të mëparshme. Është i lehtë në përdorim, për personat që kanë njohuritë bazë mbi përdorimin e kompjuterit.